



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.83

5 gusht

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.514, datë 26.7.2006	Për miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve.....	2825
Vendim i KM nr.515, datë 19.7.2006	Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.....	2829
Vendim i KM nr.517, datë 26.7.2006	Për dhënie ndihme financiare familjeve të ish-nënoficerit Namik Gjolena dhe ish-ushtarit profesionist Ardian Hanaj, të vrarë në krye të detyrës.....	2834
Vendim i KM nr.522 ,datë 26.7.2006	Për transferimin e sipërfaqes 91 m ² , komponente e pronës nr.1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, nga Ministria e Mbrojtjes në pronësi të bashkisë së qytetit Kuçovë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.....	2834
Vendim i KM nr.523, datë 26.7.2006	Për përballimin e shpenzimeve të operacionit për gjetjen e helikopterit presidencial “ Bell 222”, të rënë në detin Adriatik	2835
Vendim i ERE nr.46, datë 26.7.2006	Për fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar.....	2835
	Shpallje kërkese për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të tipit “Tokë arë“ që preket nga ndërtimi i nënstacionit 220/110/35/20 kV Koplik, Malësi e Madhe.....	2836

VENDIM
Nr. 514, datë 26.7.2006

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE
INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 1 të ligjit nr.9497, datë 20.3.2006 “Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve.
 2. Vendimet nr.542, datë 3.10.2002 “Për miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja”, nr.74, datë 6.2.2003 “Për miratimin e statutit të Agjencisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme”, dhe nr.392, datë 12.6.2003 “Për miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.
 3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STATUTI
I AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Vlera ligjore e statutit

Ky statut është dokumenti bazë, që rregullon veprimtarinë e kësaj Agjencie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, krijimi i së cilës është parashikuar me ligjin nr.9407, datë 20.3.2006 “Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve”.

Neni 2
Statusi juridik

Agjencia është person juridik, publik dhe nuk ushtron veprimtari fitimprurëse.

Neni 3
Emërtimi i shkurtuar

Emërtimi i shkurtuar i Agjencisë është “Alb-Invest”.
Selia e saj ndodhet në Tiranë në adresën: Bulevardi “Zhan d’Ark” pallatet e Lanës.

Neni 4
Stema dhe vula

Stema (logoja) e “Alb-Invest”-it miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe duhet të figurojë në të gjitha dokumentet, materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të saj.

Përmbajtja e vulës është: Republika e Shqipërisë. Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve.

KREU II OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5 **Objekti**

Agjencia do të ketë objekt të veprimtarisë:

- a) Zbatimin e strategjive dhe të politikave, zhvillimin e programeve dhe të projekteve, në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat;
- b) Kërkimin, studimin, analizimin dhe dhënien e konkluzioneve për klimën e biznesit;
- c) Nxitjen, tërheqjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja, në përputhje me përparësitë e politikës së qeverisë;
- ç) Identifikimin e mundësive për investime në Shqipëri dhe promovimin e tyre;
- d) Nxitjen e prodhimit vendas dhe të produkteve për eksport, në tregjet e huaja;
- dh) Nxitjen dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- e) Zhvillimin e veprimtarive të promovimit, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë;
- ë) Dhënien e asistencës për lehtësimin e investimeve vendase dhe të huaja, për shoqëritë eksportuese dhe sigurimin e informacionit e të shërbimeve mbështetëse për investitorët dhe eksportuesit;
- f) Bashkëpunimin me institucionet publike, financiare dhe organizatat vendase të biznesit dhe të huaja me qëllim identifikimin e barrierave të zhvillimit të biznesit;
- g) Publikimin e informacionit zyrtar për investimet, eksportet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- gj) Dhënien e ekspertizës organeve të pushtetit qendror e vendor, si dhe investitorëve të huaj për fizibilitetin e investimeve.

KREU III BURIMET E FINANCIMIT

Neni 6 **Burimet bazë të financimit**

Në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.9497, datë 20.3.2006, burim financimi është Buxheti i Shtetit. Agjencia mund të sigurojë fonde shtesë edhe nga donatorë të ndryshëm, nga shërbimet që mund të ofrojnë, si dhe nga sponsorizimet e nga të ardhurat e veprimtarive të ndryshme, që mund të organizojë.

Neni 7 **Përdorimi i fondeve**

Agjencia gëzon të drejtën e depozitimit dhe të përdorimit të mjeteve të veta financiare, në përputhje me mandatin e saj.

Financimet, që Agjencia merr nga burimet e ndryshme, përdoren vetëm për kryerjen e veprimtarisë, sipas objektivit që ka, në përputhje me rregullat e përcaktuara për institucionet buxhetore.

Agjencia krijon dhe menaxhon këto fonde:

- fondin themelor;
- fondin e mjeteve të xhiros;

- fondin rezervë, në lekë;
- fondin rezervë, në valutë;
- fonde të tjera, sipas veprimtarive specifike, që do të ndërmarrë.

KREU IV STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË

Neni 8 **Organet drejtuese**

Organet drejtuese të Agjencisë janë:

- 1) këshilli drejtues;
- 2) drejtori ekzekutiv.

Neni 9 **Përbërja e këshillit drejtues**

Këshilli drejtues përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, i cili është njëkohësisht dhe kryetar i këshillit drejtues.

Këshilli drejtues ka të drejtë të emërojë një sekretar nga punonjësit e Agjencisë të cilit i cakton dhe shpërblimin përkatës.

Neni 10 **Kompetencat e këshillit drejtues**

Këshilli drejtues është organ vendimmarrës dhe ka këto kompetenca:

- a) miraton programin e veprimtarisë së Agjencisë për vitin financiar, i cili paraqitet nga drejtori ekzekutiv;
- b) miraton bilancin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) mbikëqyr në vazhdimësi përmbushjen e objektivave të Agjencisë;
- ç) mbikëqyr e miraton përdorimin e fondeve, të siguruara jashtë Buxhetit të Shtetit.

Neni 11 **Mbledhjet e këshillit drejtues**

Këshilli mblidhet, në mënyrë periodike, të paktën një herë në dy muaj ose sa herë që e kërkon interesi i Agjencisë. Këshilli drejtues thirret nga kryetari kur këtë e kërkojnë me shkrim 3 nga anëtarët e këshillit apo me kërkesë të drejtorit. Anëtarët lajmërohen me shkrim 15 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Në njoftimin për mbledhje shënohen data, ora, vendi i zhvillimit të mbledhjes, si dhe rendi i ditës. Kur ka nevojë, njoftimit i bashkëlidhen edhe projektvendimet, që parashikohen të shqyrtohen në mbledhje.

Mbledhja drejtohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga njëri prej anëtarëve të këshillit drejtues, i përcaktuar nga kryetari. Nëse kryetari i këshillit drejtues nuk ka caktuar një anëtar, mbledhja drejtohet nga anëtari më i moshuar, që merr pjesë në mbledhje.

Neni 12 **Vlefshmëria e mbledhjeve**

Mbledhja e këshillit drejtues është e vlefshme kur në të marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të tij.

Vendimet konsiderohen të vlefshme kur për to votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

Votimi është i hapur. Në rast rezultati të barabartë votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 13

Pjesëmarrja në mbledhje e personave të tjerë

Në mbledhjet e këshillit drejtues kryetari fton këshilltarët ose dhe ekspertë të jashtëm, kur kjo diktohet nga përmbajtja e rendit të ditës.

Drejtori, këshilltarët dhe ekspertët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 14

Konflikti i interesave

Anëtarët e këshillit drejtues detyrohen të deklarojnë pozicionin e tyre në këshill, kur çështje të rendit të ditës dhe vendimet e këshillit lidhen direkt me interesat e tyre të biznesit. Në këto raste ata nuk marrin pjesë në diskutime apo në votimin e vendimeve, që merren për çështjet në shqyrtim.

Neni 15

Shpërblimi

Anëtarët e këshillit gëzojnë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit.

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit drejtues bëhet në bazë të pjesëmarrjes në mbledhje dhe përballohet nga buxheti i Agjencisë.

Masa e shpërblimit të tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

DREJTORI EKZEKUTIV

Neni 16

Mandati i drejtorit

Drejtori emërohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, për një mandat 4-vjeçar me të drejtë riemërimi.

Ai lirohet ose shkarkohet nga detyra, para mbarimit të mandatit, nga ministri përgjegjës për ekonominë:

- me kërkesë të tij;
- kur kryen vepra penale;
- kur shpërdoron kompetencat e parashikuara në statut;
- nuk kryen detyrat e përcaktuara në statut dhe ato të ngarkuara nga këshilli drejtues.

Neni 17

Tagrat e përfaqësimit

Agjencia, në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga drejtori ekzekutiv dhe, në mungesë të tij, nga zëvendësdrejtori, i cili autorizohet nga drejtori.

Neni 18

Kompetencat

Drejtori ekzekutiv ka këto kompetenca:

- a) Drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e Agjencisë;
- b) Harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së Agjencisë dhe ia paraqet për miratim këshillit drejtues;
- c) Harton dhe i paraqet këshillit, për miratim, buxhetin dhe programin vjetor të punës së Agjencisë;
- ç) Përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti i Agjencisë në përputhje me objektivat, qëllimin dhe funksionimin e Agjencisë;
- d) Raporton, të paktën, katër herë në vit, para këshillit për veprimtarinë e Agjencisë;
- dh) Bashkërendon punën me këshillin për zbatimin, me sukses, të strategjisë së qeverisë për nxitjen e biznesit dhe të investimeve;
- e) Bashkëpunon me donatorë, vendas dhe të huaj, për sigurimin e fondeve të Agjencisë, si dhe bën menaxhimin e tyre;
- ë) Krijon dhe zhvillon lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe institucioneve publike, me qëllim realizimin e detyrave dhe të objektivave të Agjencisë, si dhe të rritjes, gjithnjë e më tepër, të imazhit pozitiv të Shqipërisë te partnerët e huaj;
- f) Garanton cilësinë e materialeve informuese e promovuese, të bëra nga Agjencia, dhe shpërndarjen në kohë të tyre, institucioneve, publike dhe private, të interesuara;
- g) Lidh, në emër të Agjencisë, kontratat e punës me punonjësit e saj, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 19 **Struktura dhe organika e Agjencisë**

Struktura dhe organika përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Niveli i pagave të punonjësve do të jetë sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Ministrave për përcaktimin e pagave në administratën qendrore shtetërore dhe institucionet në varësi të tyre.

Neni 20 **Rregullat e punësimit**

Kriteret e marrjes në punë të personelit të Agjencisë, si dhe përshkrimi i vendeve të punës propozohen nga drejtori ekzekutiv dhe miratohen nga këshilli drejtues.

Neni 21 **Viti financiar**

Viti financiar i Agjencisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomik-financiar, i cili vlerësohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Drejtori ekzekutiv, brenda datës 30 prill të çdo viti, i paraqet këshillit bilancin e vitit financiar paraardhës, për shqyrtim dhe miratim.

Neni 22 **Kontrolli**

Këshilli, sipas ligjeve në fuqi, cakton ekspertë kontabël të autorizuar, për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të Agjencisë.

VENDIM
Nr. 515, datë 19.7.2006

**PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, NË VARËSI TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13 e 14 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, të neneve 21, 27 e 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Arsimit e Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkrirjen e:
 - Institutit të Kërkimeve të Bimëve të Arave, Fushë-Krujë, (IKBA);
 - Institutit të Perime-Patateve, Tiranë, (IPP);
 - Institutit të Pemtarisë, Vlorë, (IP);
 - Institutit të Kërkimeve Zooteknike, Tiranë, (IKZ);
 - Institutit të Misrit, Shkodër, (IM);
 - Institutit të Studimit të Tokave (IST);
 2. Krijimin e pesë qendrave, mbi bazën e shkrirjes së instituteve të përmendura në pikën 1, si më poshtë vijon:
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë;
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnjë;
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë;
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër.
 3. Detyrat kryesore të QTTB-ve përfshijnë:
 - identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (imputeve) të reja për vendin;
 - përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e kafshëve;
 - kërkime dhe teste në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
 - prodhimin e hallkave të larta të disa lloje farërash dhe fidanësh të certifikuara;
 - trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
 - sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
 - demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
 - përgatitjen dhe publikimin e materialeve divulgative për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
 - mbështetjen me të dhëna politikëbërjeje nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.
- Drejtimet e veçanta të veprimtarisë së çdo QTTB-je, sipas kulturave bujqësore dhe kategorive të kafshëve, përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Stacioni i Pemtarisë, Tiranë, aktualisht, pjesë e Institutit të Pemtarisë, Vlorë, kalon në administrim e varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Universitetit Bujqësor, Tiranë).

5. Stacioni i Duhanit, Cërrik, aktualisht, në varësi të Institutit të Kërkimit të Bimëve të Arave, kalon në administrim e varësi të Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve (AKDC). Detyrat kryesore të tij përfshijnë:

- testimin, përshtatjen dhe futjen e teknologjive të reja në kultivimin dhe manipulimin e duhanit;

- prodhimin e hallkave të larta dhe të farës së certifikuar të duhanit;
- testimin e rajonizimit e varieteteve të duhanit në shkallë vendi;
- kërkime, në nivel ferme, për problemet e ngritura nga fermerët për kulturën e duhanit;
- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të duhanit.

6. Shërbimi i kontrollit të plehrave në IST të përfshihet në strukturën e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), duke funksionuar si inspektorat.

7. Shkrirjen e:

- Institutit të Kërkimeve Veterinare, Tiranë, (IKV);
- Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Tiranë, (IKU).

8. Krijimin, mbi bazën e shkrirjes së instituteve të mësipërme, të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë, (ISUV), i cili mbështet teknikisht Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për problemet që lidhen me sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të kafshëve. Detyrat kryesore të veprimtarisë së tij përfshijnë:

Veterinaria:

- Monitorimin e gjendjes epizootologjike të vendit për sëmundjet virale, bakteriale, parazitare, zoonotike dhe helmimeve;

- Diagnostikimin e sëmundjeve dhe përcaktimin e skemave më efektive për luftimin e tyre;

- Prodhimin e biopreparateve veterinarë si vaksina, antigene, alergene, të materialeve diagnostikuese si antigene, serume hiperimune etj., për përdorim në diagnostikimin e sëmundjeve dhe në luftimin e tyre;

- Kontrollin mikrobiologjik të produkteve dhe të nënprodukteve ushqimore, me origjinë shtazore dhe të ushqimeve të kafshëve, të prodhuara në vend apo të importuara, si dhe ato për eksport;

- Kontrollin e mbetjeve të substancave, me efekt anabolik, të paautorizuara, biopreparateve dhe medikamenteve veterinarë për kafshët dhe shpendët e gjalla, si dhe produktet e tyre;

- Kualifikimin e specialistëve të laboratorëve veterinarë rajonalë dhe të qendrës kombëtare për certifikimin e farmacistëve veterinarë dhe trajnimin periodik të tyre;

- Hartimin, miratimin dhe shpërndarjen e teknikave dhe të metodave analitike përkatëse, bazuar në norma dhe standarde të njohura ndërkombëtare, në fushën e veprimtarisë të vet ligjore, si dhe bashkëpunimin me institute e qendra kërkimore-shkencore, si motra dhe me organizma të tjera ndërkombëtare e institute dhe qendra reference, brenda vendit;

- Certifikimin e të gjithë laboratorëve veterinarë privatë dhe laboratorëve të subjekteve private.

Veterinaria ka në varësi, administrative dhe teknike, laboratorët veterinarë rajonalë.

Laboratorët veterinarë rajonalë vendosen në qark dhe e ushtrojnë detyrën në diagnostikimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve e të shpendëve, si dhe në kontrollin e ushqimeve me origjinë shtazore dhe ushqimeve të kafshëve. Gjithashtu, zbatojnë detyrat, që i delegohen për ndjekjen e gjendjes epizootologjike në qark, mbështesin shërbimin veterinar rajonal në hartimin dhe zbatimin e programeve, për monitorimin dhe shmangien e sëmundjeve, për minimizimin dhe shmangien e rreziqeve për njerëzit.

Kontrolli ushqimor:

- Analizon, për treguesit cilësorë, të gjitha prodhimet me origjinë bimore, të tregtuara në vend;

- Analizon, për treguesit cilësorë, dhe certifikon prodhimet ushqimore me origjinë bimore për eksport;

- Bën analiza për identifikimin e falsifikimeve të ndryshme apo të shtesave në prodhimet ushqimore;

- Vlerëson parastandardet dhe rregullat teknike për prodhimet e reja ushqimore;

- Kryen analiza për etiketimin e produkteve ushqimore;

- Siguron asistencë metodologjike për laboratorët rajonalë të kontrollit ushqimor, si dhe zhvillon, zbaton metoda analitike (mbështetur në metoda të vlerësuara ndërkombëtare) dhe i shpërndan ato në laboratorët e varësisë, duke bërë të mundur integrimin dhe njëvlerësimin e tyre në të gjithë rrjetin laboratorik në vend;

- Asiston ndërmarrjet ushqimore për kryerjen analizave të prodhimeve të tyre, duke lehtësuar biznesin dhe eksportimin e produkteve, si dhe asiston dhe bashkëpunon me drejtoritë përkatëse, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për:

- politikat e zhvillimit agroindustrial;

- hartimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore për fusha të ndryshme të industrisë ushqimore;

- trajnimin e inspektorëve të sigurisë ushqimore në fushën e teknologjisë agroushqimore, për të mundësuar inspektimin e linjave dhe të ndërmarrjeve të industrisë ushqimore;

- monitorimin e tregut, për treguesit cilësorë të produkteve ushqimore.

9. Instituti i Mbrojtjes së Bimëve, Durrës, (IMB) transferohet në administrim e varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Universitetit Bujqësor, Tiranë).

10. Banka Gjenetike, në Entin Shtetëror të Farërave e Fidanëve, kalon në administrim e varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Universitetit Bujqësor, Tiranë).

11. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tokës bujqësore, trojeve, godinave e objekteve të tjera të ndërtuara mbi to, si dhe kalimin me transferim kapital të pasurisë tjetër shtetërore (të luajtshme), nga institutet ekzistuese në institucionet respektive, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kalimet të bëhen duke iu referuar bilancit kontabël në datën e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim.

Dorëzimi dhe marrja në dorëzim të bëhen nga një komision i përbashkët, i ngritur nga dy institucionet përkatëse.

Me të njëjtën procedurë të dorëzohen edhe arkivat shkencore, financiare, materialet gjenetike, si dhe çdo dokumentacion tjetër arkivor.

12. QTTB-të dhe ISUV-ja janë institucione në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të financuara nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

13. Struktura dhe numri i punonjësve të QTTB-ve dhe ISUV-së Tiranë, miratohen nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13/1. Buxheti i Shtetit përballon shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore vetëm për numrin e punonjësve, të miratuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e numrit të punonjësve buxhetorë. Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të diferencës së numrit, të miratuar sipas pikës 13 të këtij vendimi, dhe këtij numri për punonjësit me kontratë, përballohen nga të ardhurat e tyre. Për vitin 2006, numri i punonjësve, që përballohen nga Buxheti i Shtetit, të jetë 200 veta.

14. Të ardhurat e krijuara nga QTTB-të dhe ISUV-së, përdoren në përputhje me vendimin nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

15. Rishpërndarja e fondeve ndërmjet institucioneve buxhetore, që preken nga ky ristrukturim, të bëhet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Punonjësit e Bankës Gjenetike, të Stacionit të Pentarisë, Tiranë dhe të IMB-së, Durrës, me buxhetin përkatës, që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, deri më datë 31.12.2006, të kalojnë nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (Universitetin Bujqësor Tiranë).

Ky kalim bëhet në përputhje me organikën e re që do të miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

16. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pas miratimit nga Ministria e Financave, të bëjë rishpërndarjen e fondeve të miratuara brenda buxhetit të saj, për vitin 2006, në përputhje me strukturën dhe numrin e punonjësve buxhetorë, të miratuar pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

17. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t'i shtohet fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh, për të përballuar kostot e zhvendosjes së bazës materiale, për arsye të ristrukturimit dhe përshtatjen e mjediseve laboratorike.

18. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

19. Vendimet nr.29, datë 9.2.1971, nr. 199, datë 13.5.1980; nr.86, datë 18.6.1969; nr. 549, datë 29.12.1992, nr.388, datë 3.9.1992; nr.428, datë 24.9.1995 dhe nr.197, datë 18.3.1996 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

20. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1

I. Drejtimit specifike të veprimtarisë së Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, sipas kulturave bujqësore dhe kategorive të kafshëve të jenë si më poshtë:

I/a. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë

- Kulturat foragjere, fasule, gjedhi, derrat, shpendët dhe menaxhimi i integruar i fermës;
- Shërbimet për tokën dhe ujën;
- Nevoja dhe prioritetet e tjera të rajonit.

I/b. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnjë

- Perimet në sera dhe fushë të hapur;
- Gruri;
- Nevoja dhe prioritetet e tjera të rajonit.

I/c. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë

- Pemët frutore bërthamore, ulliri, vreshtat, agrumet;
- Nevoja dhe prioritetet e tjera të rajonit.

I/d. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë

- Blegtoria e imët;
- Pemët frutore farore, patatja, elbi;
- Nevoja dhe prioritetet e tjera të rajonit.

I/e. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër

- Misri;
- Nevoja dhe prioritetet e tjera të rajonit.

SHTOJCA 2

Kalimi i përgjegjësish së administrimit për pronat e paluajtshme dhe me transferim kapital i pasurisë tjetër shtetërore (të luajtshme)

1. Nga Instituti i Perime dhe Patateve, Tiranë:

Trojet, objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe Baza Eksperimentale, selitë i kalojnë Këshillit të Ministrave.

Pasuria tjetër shtetërore i kalon QTTB, Lushnjë.

2. Nga Instituti i Kërkimit të Bimëve të Arave, Fushë-Krujë:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB, Fushë-Krujë.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit Eksperimental, Korçë i kalojnë QTTB, Korçë.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit Eksperimental, Lushnjë i kalojnë QTTB, Lushnjë.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit Eksperimental, Cërrik i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve (AKDC).

3. Nga Instituti i Pemëtarisë, Vlorë

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB, Vlorë.

Pasuria shtetërore e Stacionit të Pemëtarisë, Tiranë (përfshirë serën dhe koleksionin e pemëve frutore) i kalon MASH (Universiteti Bujqësor, Tiranë).

4. Nga Instituti i Kërkimeve Zooteknike, Tiranë:

Trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to i kalojnë MASH (Universitetit Bujqësor, Tiranë).

Pasuria tjetër shtetërore i kalon QTTB, Fushë-Krujë.

Privatizohet baza materiale e aktivitetit prodhues të Stacionit të Gjedit, sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave të veçantë.

Pajisjet për kontrollin e materialit biologjik të Stacionit të Gjedit i kalojnë QTTB, Fushë-Krujë.

Trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to të Stacionit të Gjedit i kalojnë Këshillit të Ministrave.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit të Bagëtive të Imta, Korçë i kalojnë QTTB, Korçë.

5. Nga Instituti i Misrit, Shkodër:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB, Shkodër.

6. Nga Instituti i Studimit të Tokave, Tiranë:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB Fushë-Krujë.

7. Nga Instituti i Kërkimeve Veterinare dhe Instituti i Kërkimeve të Ushqimit:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë.

Trualli, godina dhe pasuria tjetër shtetërore e Kantinës së Prodhimit të Verës në IKU i kalojnë MASH (Universiteti Bujqësor, Tiranë).

8. Nga Instituti i Mbrojtjes së Bimëve, Durrës:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë MASH (Universiteti Bujqësor, Tiranë).

9. Nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve:

Pasuria shtetërore e Bankës Gjenetike në Entin Shtetëror të Farërave e Fidanëve, i kalon Mash (Universiteti Bujqësor, Tiranë).

VENDIM
Nr. 517, datë 26.7.2006

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË ISH-NËNOFICERIT NAMIK GJOLENA DHE ISH-USHTARIT PROFESIONIST ARDIAN HANAJ, TË VRARË NË KRYE TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 28 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie ndihme financiare, prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, familjes së ish-nënoficerit Namik Gjolena, dhe një ndihmë financiare, prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, familjes së ish-ushtarit profesionist Ardian Hanaj, të vrarë në krye të detyrës.
 2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
 3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 522, datë 26.7.2006

PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQES 91 M², KOMPONENTE E PRONËS NR.1095 “DEGA E MOBILIZIM-REKRUTIMIT”, KUÇOVË, NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË PRONËSI TË BASHKISË SË QYTETIT KUÇOVË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATE 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqes 91 m² komponente e pronës me numër rendor 1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, nga Ministria e Mbrojtjes, në pronësi të bashkisë së Kuçovës, në kuadër të zbatimit të projektit CARDS, të financuar nga Banka Botërore, për rikonstrukcionin e rrugës “Naftëtari 3.1.1”.
 2. Nga prona nr.1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, të hiqet sipërfaqja 91 m² nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.
 3. Bashkisë së qytetit Kuçovë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.
 4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, kryetari i bashkisë së Kuçovës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 523, datë 26.7.2006

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË OPERACIONIT PËR GJETJEN E
HELIKOPTERIT PRESIDENCIAL “ BELL 222”, TË RËNË NË DETIN ADRIATIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 107 000 (njëqind e shtatë mijë) euro, për përballimin e shpenzimeve të kontraktimit të anijes “Urania”, për gjetjen e helikopterit presidencial “Bell 222”, të rënë në detin Adriatik.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për çeljen e këtij fondi.
 4. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 46, datë 26.7.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET
E DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të nenit 9, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 7 të ligjit nr.9512, datë 10.4.2006 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.7.2006, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga anëtari i Bordit të Komisionerëve z.Adriatik Bego, për miratimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar.
- Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, si dhe këshilltari i Bordit të Komisionerëve, ta përpunojnë këtë rregullore në përputhje me projektdraftin e paraqitur (bashkëngjitur).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të tipit “Tokë arë” që preket nga “Ndërtimi i nënstacionit 220/110/35/20 kV Koplík, Malësi e madhe”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: “KESH” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet dhe masën përkatëse të kompensimit, të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për të gjithë pronarët, sipas listës emërore të mëposhtme.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 220/110/35/20 KV KOPLIK, MALËSI E MADHE”

Qarku: Shkodër

Rrethi: Malësi e Madhe

Komuna: Qendër Koplík

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore arë

Nr.	Shpronësimi i pasurisë së paluajtshme								Adresa e pronarëve
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip.e tokës që zë nënstacioni m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera e kompesimit në lekë	
1	Skënder	Musli	Delishaj	1238	28	1192	850	1 013 200	Komuna Qendër Koplík
2	Enver	Muhamet	Zeka	1238	17	6702	850	5 696 700	Komuna Qendër Koplík
3	Muhamet	Ymer	Zeka	1238	16	1123	850	954 550	Komuna Qendër Koplík
4	Sami	Xhelal	Zekaj	1238	18	4745	850	4 033 250	Komuna Qendër Koplík
5	Jonuz	Riza	Delishaj	1238	15/1	2272	850	1 931 200	Komuna Qendër Koplík
6	Sami	Xhelal	Zekaj	1238	15/2	5800	850	4 930 000	Komuna Qendër Koplík
7			Shtetërore	1238	20	1481	-	-	Komuna Qendër Koplík
8			Shtetërore	1238	1311/a	322	-	-	Komuna Qendër Koplík
9			Shtetërore	1238	19/a	115	-	-	Komuna Qendër Koplík
			Total	-	-	23752	-	18558 900	

VO: Pasuritë e paluajtshme nr.20, 1311/a, 19/a janë pronë shtetërore dhe do t'i kalojnë KESH sh.a. pa shpërblim.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) | 1500 |
| 2. | PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) | 600 |
| 3. | PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... | 1500 |
| 4. | PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) | 1500 |
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... | 1500 |
| 2. | TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... | 2000 |

BOTIME TË REJA

- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT | 500 |
| 2. | KODI DOGANOR | 1000 |
| 3. | KODI DETAR | 1000 |

Hyri në shtyp më 3.8.2006
 Doli nga shtypi më 5.8.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
 Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë